



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

---

**Dhjetor, 2020**  
**Modifikuar në dhjetor 2021**  
**Modifikuar në nëntor 2024**

# **Standardet e mentorimit dhe formimit të komisioneve të tezave master në Fakultetin e Edukimit**

## **Hyrje**

Studimet master ngërthejnë në vete një numër sfidash dhe ajo që është esenciale për përgatitjen e studentëve që të funksionojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin e fushës së studimit është cilësia e punës në tezën e masterit (krahas cilësisë së programit si tërësi). Fakulteti i Edukimit ka caktuar standardet e punës hulumtuese në nivel master në *Doracakun e Temave Master*, dokument i cili shërben si udhëzues për personelin dhe studentët gjatë procesit të realizimit të punimit master (fuqizimi dhe monitorimi i zbatimit të standardeve të projekteve dhe tezave master trajtohen në procese jasht këtij dokumenti). Krahas përkushtimit dhe kapacitetit të studentit në realizimin e hulumtimit master, faktorë esenciale që përcaktojnë cilësinë e punës në tezën e masterit janë cilësia e mentorimit dhe cilësia e punës së komisionit vlerësues. Andaj, adresimi i këtyre dimensioneve është esenciale në cilësinë e punës në tezën e masterit në fazat vijuese në zhvillimin e Fakultetit të Edukimit.

Sipas rregullores aktuale për studimet master (Nr. 1/334, datë 31 maj 2023, neni 10 pika 3), dy nga tre anëtarët e komisionit të tezës së masterit duhet të jenë nga fusha e ngushtë e tezës master. Për anëtarin e tretë të komisionit duhet të vendoset nga parimi që studenti të ketë një komision sa më profesional dhe të synohet rritja e bashkëpunimit kolegjial përtej departamenteve dhe duke avancuar qasjen ndërdisiplinare të studimeve në fakultet, por pa bërë kompromis komponentën e cilësisë. Kriter bazë në këtë kontekst merren konceptet që trajtohen në temën e propozuar dhe profili e sfondi shkencor i publikimeve të anëtarit/ëve të komisionit.

Qëllimi dhe shfrytëzimi i këtij dokumenti përmbledhet në tri pika:

1. Udhëzim për departamentet në propozimin e komisioneve të tezave master në mënyrë që komisionet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe kriteret profesionale;
2. Udhëzim për Këshillin e Fakultetit gjatë procesit të miratimit të projektpropozimeve dhe komisioneve të propozuara nga departamentet;
3. Avancimi i iniciativës së profilizimit/fokusimit të personelit akademik në fushat ku ata mund të jenë më të dobishëm për studentët që janë në proces të realizimit të tezave master.

Pra qëllimi i përgjithshëm është që të rritet cilësia e punimeve të tezave master në fakultet. Dokumenti është hartuar në frymën e rekomandimit për departamentet, Këshillin e Fakultetit dhe personelin akademik në funksion të harmonizimit të praktikave dhe procedurave nga departamenti në departament dhe krijimit të një standardi dhe praktike zhvillimore në institucion në drejtim të ngritjes së cilësisë së punës së studentëve në tezat e masterit dhe në mentorimin e tyre.

### **Caktimi i mentorit të temës master**

Mentori i temës master duhet të ketë nivelin e kualifikimit profesor asistent e më lartë ndërsa për të mentoruar një temë master profili i profesorit duhet të i përshtatet natyrës së temës së propozuar sa më shumë që është e mundur. Detyrat dhe përgjegjësitë e mentorit janë përcaktuar në *Doracakun e Tezave Master* dhe duhet të shërbejnë si udhëzues për të gjitha palët gjatë procesit të mentorimit.

Profili adekuat për mentorim duhet të shikohet nga këndvështrimi i disa elementeve që e përbëjnë sfodin dhe e përcaktojnë praktikën profesionale dhe performancën e secilit në ambient akademik. Më saktësisht, në gjykimin e përshtatshmërisë së personelit akademik për mentorim të tezave master merret për bazë (i) natyra e studimeve të personelit në nivel të doktoratës, (ii) puna shkencore si publikime të ndryshme në revista shkencore, libra etj., si dhe (iii) angazhimet e tjera si pjesëmarrja në konferenca shkencore të fushës dhe angazhime të ngjajshme zhvillimore duke përfshirë edhe trajnimet akademike të certifikuara post-doc apo të ngjajshme. Profili adekuat për mentorim të një teme do të duhej të reflektonte në kushte ideale të tri dimenzionet më lartë, ose së paku dy nga tri dimenzionet, ndërsa në mungesë të kuadrit të mjaftueshëm për ndonjë fushë atëherë duhet të bëhet zgjidhja më e mirë e mundshme për studentin.

Vështirësi në definimin e përshtatshmërisë së mentorimit shfaqen sidomos në temat ndërdisiplinare ku trajtohen dy koncepte arsimore. Për shembull, të tilla janë temat si zbatimi i edukimit inkluziv në lëndën njeriu dhe shoqëria (apo shkencat shoqërore etj.), komunikimi në menaxhimin e shkollës, zbatimi i teknologjisë në edukimin inkluziv/në edukimin parashkollor/në mësimdhënien e historisë/fizikës/gjuhës, zbatimi i strategjive të caktuara të mësimdhënies në një fushën e matematikës/teknologjisë/kimisë/gjeografisë etj.

Së pari, caktimi/prioretizimi i mentorit bëhet duke u bazuar në natyrën e programit ky realizohet ajo temë. Për shembull, në rast se një temë e tillë (ndërdisciplinare si më lartë) realizohet në programin e mësimdhënies së historisë/gjuhës/teknologjisë (etj.) atëherë caktimi i mentorit bëhet nga profili i fushës përkatëse të programit. Shkallëzimi i dytë i kriterëve është që përderisa tema e propozuar duhet të jetë në harmoni me qëllimet e programit të studimit, mentori i propozuar duhet të ketë profilin e programit dhe kështu në harmoni me temën (shih kriteret specifike në paragrafin 2 më lartë në këtë seksion). Ndërsa, në rast se mentorët potencial nga fusha e programit/temës përkatëse ndihen se nuk kanë përgatitje dhe përvojë të duhur në fushën e caktuar arsimore, atëherë fakulteti ka tri opsione për veprim: (i) cakton një bashkë-mentor (vetëm në raste përjashtimore por të arsyetuara me shkrim) për të plotësuar ndihmën për studentin; (ii) formon komisionin e vlerësimit me anëtarë që plotësojnë natyrën e temës, apo (iii) të identifikojë një mentor që është më i përafërt me fushën (këto duhet të sqarohen në procesverbalet e mbledhjeve të departamentit duke theksuar pamundësinë për të bërë zgjidhje tjetër). Përderisa në programet e edukimit të përgjithshëm si p.sh Mësimdhënia dhe kurrikula (por jo vetëm) mund të ketë hapësirë për interpretime më të gjëra, por parimet e lidhjes së temës me programin dhe lidhja e profilit dhe sfondit të mentorit me temën e propozuar duhet të zbatohen në përpikëri..

Dekanati dhe Shefat e departmaneteve udhëzojnë studentët që të lexojnë në web faqe të fakultetit materialet e ndryshme rreth profilizimit të personelit akademik. Studentët poashtu do të shikojnë CV-të e personelit akademik për të patur më të lehtë të identifikojnë mentorin për tezën e tyre të masterit (sidomos duke ditur se jo i gjithë personeli i ka dhënë mësim).

### **Komisioni i tezave master**

Sipas rregullores së studimeve master, së paku dy anëtarë të komisionit duhet të jenë nga fusha e ngushtë e temës master (pra mentori dhe një anëtar tjetër/kryetari i komisionit). Për anëtarin e tretë të komisionit Departamenti dhe Këshilli duhet të vendosin sipas parimit në vijim:

- Për temat e programeve të mësimdhënies lëndore merren parasysh disa elemente:
  - o në fushat e ngushta të shkencave natyrore dhe shoqërore inkurajohet edhe integrimi lëndor në temë dhe në komision (duke marrë në konsideratë të tre anëtarët e komisionit) por duke mos shkelur nenin 10.3 të rregullores për studime master ku specifikohet që dy anëtarë të komisionit të jenë nga fusha e ngushtë e temës. Kjo është në frymën e trendit të integritit lëndor dhe adreson edhe mungesën e numrit adekuat të personelit akademik në fakultet në disa fusha, por kjo nuk mund të interpretohet si e drejtë për të mentoruar në një program tjetër jashtë profilit tonë;
  - o Sipas specifikave të temave të caktuara anëtarin e tretë mund të jetë nga psikologjia, pedagogjia/edukimi i përgjithshëm, filozofia apo sociologjia, varësisht nga natyra e temës. Kjo avancohet argumentimin që studimet dhe tezat e masterit në Fakultet të Edukimit (në programet e mësimdhënies lëndore) janë të karakterit arsimor dhe

dallojnë nga puna që bëhet në fakultetet akademike si dhe zhvillojnë bashkëpunimin kolegjal dhe ndërdisiplinar të studimit të edukimit. Profili i anëtarit të propozuar (studimet e doktoratës, punimet shkencore, dhe përvoja tjetër) në këtë rast duhet të jetë i lidhur me konceptet e trajtuara në temën e tezës master.

- Për tezat e masterit nga fusha e përgjithshme e edukimit, anëtari i tretë duhet të caktohet në bazë të kritereve të njëjta duke marrë parasysh edhe zhvillimin e bashkëpunimit kolegjal dhe interesimit të kolegëve të tjerë për zgjerim të interesimit të tyre të hulumtimit e mësimdhënies. Por, kriteret që komisioni të jetë sa më profesional për studentin duhet të zbatohen me përpikëri. Në këtë kontekst merret parasysh edhe natyra e studimeve të doktoratës të profesorit, punimet shkencore të tij/saj si dhe angazhimi tjetër profesional rreth temës së caktuar (punimet shkencore, trajnime të ndryshme të certifikuara si studime post-dok, prezantime në konferenca shkencore etj.). Edhe në këtë departament respektohen parimet e rregullores për studime master (neni 10. Pika 3) që dy anëtarë të jenë nga fusha e ngushtë e temës së propozuar.
- Në programin e masterit Edukimi për STEAM duhet të zbatohen parimet e njëjta që tema e propozuar të lidhet me natyrën e programit dhe sfondi i mentorit të lidhet me temën e propozuar. Parimi i njëjtë vlen edhe për formimin e komisionit që studenti të ketë një komision sa më profesional. Kooncepti i ndërdisiplinaritetit në këtë program konceptohet ndryshe dhe krahas natyrës së programit dhe departamenti duhet të zhvillojë udhëzime shtesë që orientojnë edhe studentët edhe mentorët potencial. Këshilli i Fakultetit duhet të njoftohet për udhëzimet shtesë për këtë program që zhvillohen në departament.

### **Aspekte të implementimit**

Departamentet (sipas strukturës organizative që funksionon në fakultet), trajtojnë projektpropozimet duke zbatuar qasjen transparente (ku secili anëtar i departamentit pranon materialin në kohën e ftesës për mbledhje dhe duhet të theksohet pritja që secili anëtarë ta ketë studjuar atë para mbledhjes). Departamenti para mbledhjes mund të caktojë anëtarë të cilët janë më të thirrur për fushën e temës specifike dhe mandej të udhëheqin diskutimin në takim të departamentit për të përcaktuar nëse tema plotëson standardet minimale. Të njëjtë mund edhe të caktohen mandej anëtarë të komisionit për të përcjellur realizimin e hulumtimit dhe për të vlerësuar atë deri në mbrotje. Menaxhmenti i departamentit duhet të sigurojë që përgjegjësia e miratimit apo refuzimit të projektpropozimeve është kolektive dhe jo individuale e anëtarëve.

Menaxhmenti i departamentit duhet të sigurohet që gjatë shqyrtimit të projektpropozimeve të bëhet lidhja me standardet e përcaktuara në *Doracakun për Tezat e Masterit* dhe të vendosin procesin e rrtijes së vazhdueshme të standardit minimal duke identifikuar dhe adresuar sfidat në programe dhe tek mentorët e caktuar.